

## STATUTI

### I

#### SHOQERISE BETON EXPRESS 2018 SHPK

Ne kete statut:

“Ligji” eshte Ligji nr. 9901, date 14.4.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", te ndryshuar

“Statuti” eshte statuti i Shoqerise

### KREU 1

#### THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA, KAPITALI

##### Neni 1

#### Themelimi dhe te dhenat identifikuese te themeluesve

1.1 Sot me dt. 24/09/2018, ne, themeluesit, me vullnetin tone te lire, për arritjen e objektivave ekonomike të përbashkët, duke dhënë kontribute tona, kemi krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin BETON EXPRESS 2018 SHPK e cila do te funksionojë sipas legjislacionit shqiptar,

1.2 Themeluesit e shoqerise jane :

- Mond Bega, atesia Irfan, shtetas shqiptar, lindur ne Lushnje me 31/12/1970 dhe banues ne Tirane, identifikuar me leternjoftimin me NID H01231017D, madhor e me zotesi te plote per te verpuar;
- Benard Velo, atesia Memiko, shtetas shqiptar, lindur me 22/07/1991 ne Tirane dhe banues ne Tirane, identifikuar nga leternjoftimi me NID J10706061T, madhor e me zotesi te plote per te vepruar,

##### Neni 2

#### Objekti i veprimtarise

2.1 Shoqeria do te kryej veprimtarine e meposhtme: “Prodhim dhe shitje te betonit te gjitha markave dhe prodhime elementesh te betonit te parafabrikuar”

2.2 Shoqëria tregtare mund të ushtrojë çdo veprimtari, e cila nuk ndalohe me ligj, duke bere ndryshimet e nevojshme dhe regjistrimine e tyre ne Qendren Kombetare te Biznesit.



### Neni 3

#### Kohezgjatja e shoqerise

3.1 Kohezgjatja e shoqerise eshte pa afat.

### Neni 4

#### Selia e shoqerise

4.1 Selia e shoqerise ndodhet brenda territorit te Republikes se Shqiperise ne adresen " Njesia Bashkiake Nr.2, Rr. "Faik Konica" Pall. AL-GI Nr. 1, Shk.1, K.1, H.3, Tirane

4.2 Per qellime komunikimi adresa e emailit te shoqerise eshte : [betonexpress18@gmail.com](mailto:betonexpress18@gmail.com) dhe nr cel +355 69 27 24 667

### Neni 5

#### Kapitali i shoqerise

5.1 Kapitali i ortakeve te shoqerise eshte ne monedhen Leke. Ortaket kane vendsur qe kapitali i nenshkruar i saj te jete 10 000 (dhjete mije) Leke, i ndare ne 2 kuota ku secila kuote ka vleren 5000 (pese mije) Leke

5.2 Pjesemarrja e ortakeve themelues ne kapitalin e shoqerise eshte si me poshte :

- Ortaku themelues z. Mond Bega eshte kontribues ne vleren 8 000 leke qe perben 80% e kapitalit te shoqerise dhe si rrjedhim zoterues i 1 kuote

- Ortaku themelues z. Benard Velo eshte kontribues ne 2000 Leke qe perben 20 % e kapitalit te regjistruar te shoqerise dhe si rrjedhim zoterues i 1 kuote

5.3 Ortaket themelues bien dakort qe te shlyejne kapitalin e regjistruar brenda 30 diteve nga hartimi i ketij statuti duke e depozituar ate ne llogarine bankare te hapur ne emer te shoqerise;

### Neni 6

#### Modalitetet e zmadhimit, zvogelimit dhe transferimit te kapitalit

6.1 Kapitali zmadhohet ose zvogelohet kur ploteson kushtet ligjore dhe duke ndjekur procedurat e parashikuara ne ligj ne momentin e vendosjes se zmadhimit ose zvogelimit te tij.



6.2 Asnjëri nga ortakët nuk mund të detyrohet të rris ose zvogëlojë përqindjen e pjesëmarrjes në shoqëri.

6.3 Kuotat e shoqërisë transferohen sipas parashikimeve të ligjit duke u marrë me parë miratimin e shoqërisë. Çdo ortakë gëzon të drejtën e parablerjes së tyre. Kjo e drejtë nuk aplikohet në rastin e dhurimit të kuotave.

## KREU 2

### ORGANET VENDIMARRËSE/DREJTUESE/ADMINISTRUESE

#### Neni 7

##### Organi vendimarrës i shoqërisë

7.1 Organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë është Asambleja e përgjithshme e ortakëve.

7.2 Asambleja e ortakëve mbledhet sa herë është e nevojshme për mbarevajtjen e shoqërisë por jo më pak se 3 herë në vit.

7.3 Asambleja e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;



- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

7.4 Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "e" dhe "ë" të pikes 7.3 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.

7.5 Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

7.6 Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.

7.7 Asambleja e përgjithshme thirret nepermjet njoftimit me shkresë ose me njoftim nepermjet postes elektronike te cilet duhet te permbajne vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës dhejo me vone se 10 dite nga dita e zhvillimit te mbledhjes se asamblese.

## Neni 8

### Administrimi i shoqerise

8.1 Personi me te dhenat e meposhtme caktohet Administrator i shoqerise per nje periudhe 5-vjecare me te drejte riemerimi:

Te dhenat e identifikimit :

- Benard Velo,

Specimenet e nenshkrimit

Benard Velo 



Adresa Rr. Aleksander Moisiu , pall 46 Tirane, Cel +355692724667

## Neni 9

### Emërimi, shkarkimi, të drejtat dhe detyrimet e Administratorit

9.1 Administratori i shoqërisë emërohet dhe shkarkohet me vendim unanim të Asamblesë së ortakeve për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë ripërtëritje.

9.2 Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryej të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësoj shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatit dhe nënshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijoj një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryej regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportoj përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryej detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

## Neni 10

### Baza ligjore



Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine ekonomike ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut , do te zbtohen dispozitat e ligjit nr. 9901, date 14.4.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe cfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e shqiperise.

#### Neni 11

#### Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin nga interpretimi ose zbatimi i ketij statuti si dhe per mosmarreveshjet midis shoqerise dhe te treteve do te jene kompetente gjykatat shqiptare.

#### ORTAKET

E

#### SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

#### BETON EXPRESS 2018 SHPK

Benard Velo

Benard Velo 

Mond Bega

Mond Bega 